

URDHËR
Nr. 34, datë 1.3.2023

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SË SIGURISË PORTUALE TË PORTIT
‘MARINA LIMION’, SARANDË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “b”, të nenit 401, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947”, si dhe të shkronjës “b”, të nenit 5, të ligjit nr. 168/2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të portit ‘Marina Limion’, Sarandë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale dhe porti “Marina Limion”, Sarandë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGIJË**
Belinda Balluku